



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. ~~1997~~ prot.

Tiranë, më 15.04.2026

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

**SPECIALIST FINANCE, NË DREJTORINË E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, PRANË QENDRËS
SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin specialist finance, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë një gamë të gjerë të cilësisë në fushën e administrimit dhe menaxhimit financiar.
2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:
 - ✓ Diplomë universitare në nivelin Master Profesional fushën ekonomike/financiare.
 - ✓ Përvojë pune mbi 1vit, preferohet përvoja në administratë.
 - ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi të mira komunikimi në një nga gjuhët e BE (preferohet gjuha angleze).
 - ✓ Të ketë aftësi shumë të mira në përdorimin e programeve bazë kompjuterike si paketa office;
 - ✓ Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar;
 - ✓ Të ketë njohuri mbi shkrimin akademik.
 - ✓ Të ketë aftësi të të dëgjuarit, të shkrimit dhe të folurit në mënyrë efektive.
 - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativë.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta kohore.
 - ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
 - ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 29.04.2026 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrt

